

PHILIPS

Soundbar

Seria 8000

TAB8405

Manuali i përdorimit



Regjistroni produktin tuaj dhe merrni ndihmë në
www.philips.com/support

Përmbajtja

1 E rëndësishme	3	4 Përdorimi i Soundbar	16
Siguria	3	Ndezja dhe fikja	16
Kujdesi për produktin	4	Gjendje pritjeje automatike	16
Kujdesi për mjedisin	4	Zgjedhja e modaliteteve	16
Pajtueshmëria	4	Ndryshimi i volumit	16
Ndihmë dhe mbështetje	5	Modaliteti i tingullit Dolby	16
Paralajmërimi FCC dhe deklarata IC për përdoruesit (vetëm SHBA dhe Kanada)	5	Rivendosje e parametrave të fabrikës	17
		Menuja e konfigurimit	17
		Punimi me Bluetooth	18
		Punimi me AUX / OPTICAL / HDMI ARC	19
		Punimi me USB	19
		Dëgjimi i Spotify	20
		Përditësimi i firmuerit	20
2 Soundbar juaj	6	5 Të dhënat e produktit	21
Çfarë ka në kuti	6		
Aparati	6	6 Zgjidhja e problemeve	22
Konektorët	7	Markat tregtare:	24
Subwoofer me valë	7		
Telekomanda	8		
Përgatitja e telekomandës	8		
Vendosja	9		
Montimi në mur	10		
3 Lidhja	11		
Dolby Atmos®	11		
Lidhja me prizën HDMI	11		
Lidhja me një prizë optike	12		
Lidhja me prizën AUX	12		
Lidhja me energjinë	13		
Çiftimi me Subwoofer	13		
Lidhja me Wi-Fi (punim me Wireless)	14		

1 E rëndësishme

Lexoni dhe kuptoni të gjitha udhëzimet para se ta përdorni produktin. Garancia nuk është e vlefshme nëse dëmtimi shkaktohet nga mosndjekja e udhëzimeve.

Siguria

Rrezik goditjesh elektrike ose zjarri!

- Para se të bëni ose të ndryshoni ndonjë lidhje, sigurohuni që të gjitha pajisjet të jenë shkëputur nga energjia.
- Asnjëherë mos e ekspozoni produktin dhe aksesoret ndaj shiut ose ujit. Asnjëherë mos vendosni enë me lëngje, si për shembull vazo, pranë produktit. Nëse mbi produkt ose brenda produktit derdhen lëngje, hiqeni nga priza menjëherë. Kontaktoni shërbimin e kujdesit ndaj klientit për ta kontrolluar produktin para se ta përdorni.
- Asnjëherë mos e vendosni produktin dhe aksesoret pranë flakëve të ndezura ose burimeve të tjera të nxehtësisë, si për shembull drita direkte e diellit.
- Asnjëherë mos futni objekte në hapësirat e ventilimit ose në hapësirat e tjera në produkt.
- Në rastet kur spina e energjisë ose një bashkues i pajisjeve përdoret si mjet për shkëputjen nga energjia, mjeti i shkëputjes duhet të jetë në pozicion që arrihet me lehtësi.
- Bateria (paketa e baterive ose bateritë e instaluara) nuk duhet të ekspozohet ndaj nxehtësisë së tepërt, si për shembull ndaj dritës së diellit, zjarrit ose gjërave të ngjashme.
- Shkëputeni produktin nga energjia para se të ndodhin stuhitë me vetëtimë.
- Kur e shkëputni kordonin e energjisë, tërhiqni gjithmonë spinën, asnjëherë kabllin.
- Përdoreni produktin në klima tropikale dhe/ose mesatare.

Rrezik qarku të shkurtër ose zjarri!

- Për të parë shenjat identifikuese dhe vlerat e energjisë, shikoni etiketën e të dhënave mbrapa ose poshtë produktit.
- Para se ta lidhni produktin me prizën e energjisë, sigurohuni që tensioni i

energjisë të përputhet me vlerën e printuar mbrapa ose poshtë produktit. Asnjëherë mos e lidhni produktin me prizën e energjisë nëse tensioni është i ndryshëm.

Rrezik lëndimi ose dëmtimi të produkt!

- Për montimin në mur, ky produkt duhet të fiksohet në mur sipas udhëzimeve për montimin. Përdorni vetëm kllapën e dhënë për montimin në mur (nëse ka). Montimi jo i mirë në mur mund të shkaktojë aksidente ose dëmtime. Nëse keni ndonjë pyetje, kontaktoni kujdesin për klientin në vendin tuaj.
- Asnjëherë mos e vendosni produktin ose ndonjë objekt tjetër mbi kordonet e energjisë ose mbi pajisje të tjera elektrike.
- Nëse produkti transportohet në temperatura nën 5°C, shpaketojeni produktin dhe prisni derisa temperatura të arrijë temperaturën e ambientit para se ta lidhni me prizën e energjisë.
- Disa pjesë të këtij produkti mund të jenë prej xhami. Trajtojeni me kujdes për të shmangur lëndimet dhe dëmtimet.

Rrezik i nxehtësisë së lartë!

- Asnjëherë mos e instaloni produktin në një hapësirë të mbyllur. Lini gjithnjë një hapësirë prej të paktën dhjetë centimetra anembanë produktit për ajrim. Sigurohuni perdet ose objekte të tjera të mos mbulojnë hapësirat e ventilimit në produkt.

Rrezik kontaminimi!

- Mos i bashkoni bateritë (të vjetrat me të rejat, ose bateritë e karbonit me ato alkaline, etj.).
- KUJDES: Rrezik shpërthimi nëse bateritë nuk vendosen si duhet. Ndërrojeni vetëm me bateri të njëjtë ose me të njëjtin tip.
- Hiqini bateritë nëse janë shkarkuar ose nëse telekomanda nuk do të përdoret për kohë të gjatë.
- Bateritë përmbajnë substanca kimike, ndaj duhet të hidhen si duhet.

Rrezik i gëlltimit të baterive!

- Produkti/telekomanda mund të kenë një bateri në formë monedhe/kopse, e cila mund të gëlltitet. Mbajeni gjithnjë baterinë larg fëmijëve! Nëse gëlltitet, bateria mund të shkaktojë lëndime serioze ose vdekje. Mund të ndodhin dëgje të brendshme brenda dy orësh pas gëlltimit.

- Nëse dyshoni se një bateri mund të jetë gëlltimit ose futur në ndonjë pjesë të trupit, kërkoni menjëherë ndihmë mjekësore.
- Kur i ndërroni bateritë, mbajini gjithnjë bateritë e reja dhe ato të përdorura larg fëmijëve. Sigurohuni që vendi i baterive të jetë komplet i mbyllur pasi ta ndërroni baterinë.
- Nëse vendi i baterive nuk mund të sigurohet mirë, mos e përdorni më produktin. Mbajeni larg fëmijëve dhe kontaktoni prodhuesin.



Kjo është një pajisje CLASS II me izolim të dyfishtë, dhe nuk ka tokëzim mbrojtës.



Tensioni AC



Përdorni vetëm furnizimet me energji që tregohen në manualin e përdorimit.

Kujdesi për produktin

Përdorni leckë me mikrofibra për ta pastruar produktin.

Kujdesi për mjedisin

Hedhja e produktit të vjetër dhe e baterive



Produkti është projektuar dhe prodhuar me materiale dhe komponentë të cilësisë së lartë, të cilat mund të riciklohen dhe të ripërdoren.



Ky simbol mbi një produkt do të thotë se produkti mbulohet nga Direktiva Evropiane 2012/19/EU.



Ky simbol do të thotë se produkti përmban bateri që mbulohen nga Direktiva Evropiane 2013/56/EU të cilat nuk mund të hidhen së bashku me mbetjet e zakonshme shtëpiake. Informohuni lidhur me sistemet vendëse për grumbullimin e produkteve elektrike dhe elektronike dhe të baterive. Ndiqni rregullat vendëse dhe asnjëherë mos e hidhni produktin dhe bateritë së bashku me mbetjet e zakonshme shtëpiake. Hedhja e duhur e produkteve të vjetra ndihmon në parandalimin e pasojave negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Heqja e baterive njëpërdorimëshe

Për t'i hequr bateritë njëpërdorimëshe, shikoni pjesën për montimin e baterive.

Për pajisje 5G Wi-Fi

Pajisja për operim në bandën 5150–5350 MHz është vetëm për përdorim të brendshëm për të pakësuar potencialin për interferenca të dëmshme ndaj sistemeve satelitore celulare co-channel.

AT	BE	BG	CZ	DK	EE	FR
DE	IS	IE	IT	EL	ES	CY
LV	LI	LT	LU	HU	MT	NL
NO	PL	PT	RO	SI	SK	TR
FI	SE	CH	UK	HR		

Pajtuëshmëria

Produkti u përmbahet kërkesave të Komunitetit Evropian për interferencat radio. Këtu TP Vision Europe B.V. deklaron se ky produkt është në përputhje me kërkesat themelore dhe masat e tjera përkatëse të Direktivës 2014/53/EU. Mund ta gjeni deklaratën e konformitetit në www.p4c.philips.com.

Ndihmë dhe mbështetje

Për mbështetje intensive online, vizitoni www.philips.com/support to:

- shkarkoni manualin e përdorimit dhe udhëzuesin e shpejtë
- shikoni udhëzuesit me video (të disponueshme vetëm për disa modele)
- gjeni përgjigje për pyetje të bëra shpesh (FAQ)
- na dërgoni pyetje me email
- bisedoni me përfaqësuesit tanë.

Ndiqui udhëzimet në faqen e internetit për të zgjedhur gjuhën, dhe më pas vendosni numrin e modelit të produktit.

Ose mund të kontaktoni shërbimin e klientit në vendin tuaj. Para se të kontaktoni, mbani shënim numrin e modelit dhe numrin e serisë së produktit. Mund t'i gjeni këto informacione mbrapa ose poshtë produktit.

Paralajmërimi FCC dhe deklarata IC për përdoruesit (vetëm SHBA dhe Kanada)

INFORMACIONI FCC

SHËNIM: Kjo pajisje është testuar dhe është zbuluar se i përmbahet limiteve për një pajisje digjitale të Klasit B, sipas pikës 15 të rregullave FCC. Këto limite janë vendosur për të siguruar mbrojtje të arsyeshme ndaj interferencave të dëmshme në një ambient banimi. Pajisja gjeneron, përdor dhe mund të rrezatojë energji të frekuencave radio dhe, nëse nuk instalohet dhe nuk përdoret sipas udhëzimeve, mund të shkaktojë interferenca të dëmshme ndaj komunikimeve radio.

Sidoqoftë, nuk ka garanci që interferenca nuk do të ndodhë në një instalim të veçantë. Nëse kjo pajisje shkakton interferencë të dëmshme ndaj sinjalit të radios ose televizionit, gjë e cila mund të përcaktohet duke e ndezur dhe fikur pajisjen, përdoruesi inkurajohet që të përpiqet ta ndreqë interferencën nëpërmjet një ose më shumë prej masave të mëposhtme:

- Ndryshoni orientimin ose lëvizni antenën.
- Largojeni më tepër pajisjen nga marrësi.
- Lidhni pajisjen në një prizë në një qark të ndryshëm nga ai me të cilin është lidhur marrësi.
- Konsultohuni me shitësin ose me një teknik radiosh/televizorësh me përvojë për ndihmë.

IC-Canada: CAN IECES-3(B)/NMB-3(B)

Kjo pajisje përmban transmetues/marrës të përjashtuar nga licencat të cilat i përmbahen RSS-ve të Inovacionit, Shkencës dhe Zhvillimit Ekonomik të Kanadasë të përjashtuar nga licencat. Përdorimi i nënshtrohet dy kushteve të mëposhtme:

1. Kjo pajisje nuk duhet të shkaktojë interferencë.
2. Kjo pajisje duhet të pranojë çfarëdo interference, duke përfshirë interferencat që mund të shkaktojnë punim të padëshiruar të pajisjes.

Paralajmërim FCC&IC:

- Kjo pajisje duhet të instalohet dhe përdoret në distancë minimale prej 20cm, mes radiatorit dhe trupit.
- Ndryshimet ose modifikimet në këtë aparat që nuk janë miratuar shprehimisht nga pala përgjegjëse për pajtueshmërinë mund ta bëjnë të pavlefshëm autoritetin e përdoruesit për ta përdorur pajisjen.


2 Soundbar juaj

Urime për blerjen tuaj, dhe mirë se vini në Philips! Për të përfutur plotësisht nga mbështetja që jep Philips, regjistroni Soundbar në www.philips.com/support.

Çfarë ka në kuti

Kontrolloni dhe shikoni çfarë ka në kuti:


- Soundbar x 1
- Subwoofer me valë x 1
- Telekomanda x 1
- Kordoni i energjisë * x 4
- Kit për montimin në mur x 1
(Kllapa muri x2, vida x2, upa x2)
- Manuali i përdorimit / Karta e garancisë / Fleta e sigurisë / Model për montimin në mur x 1



Soundbar



Telekomanda




Subwoofer me valë



Manuali i përdorimit



2 X
Kordoni i energjisë *



Kllapa e murit
Kapaku
Vidat (për murin)




Karta e garancisë
Fleta e sigurisë
Modeli i montimit në mur

- * Sasia e kordonit të energjisë dhe lloji i spinës mund të ndryshojë sipas zonave.
- Imazhet, ilustrimet dhe vizatimet që tregohen në këtë manual përdorimi janë vetëm për referencë, produkti i vërtetë mund të ndryshojë në pamje.

Aparati

Kjo pjesë përmban një përmbledhje të aparatit.



- ① - (Butoni i volumnit)
Uleni volumn.
- ② + (Butoni i volumnit)
Ngrijeni volumn.
- ③ ►|| (Butoni Luaj/Pauzë)
Filloni, ndaloni ose vazhdoni luajtjen.
- ④ ↺ (Butoni i burimit)/çiftimit me Bluetooth
 - Zgjidhni një burim hyrjeje për Soundbar.
 - Mbajeni shtypur për të aktivizuar funksionin e çiftimit në modalitetin e Bluetooth ose për ta shkëputur pajisjen Bluetooth të çiftuar aktualisht.
- ⑤ ⏻ (Butoni Standby-On)


Gjendja e energjisë	Veprimi	Funksioni
Ndezur		Gjendja e ndjekjes së burimit
Gjysmë Standby	Shtypni butonin ⏻ një herë	- Wi-Fi është ende i ndezur. - Mbështet ende Play-Fi dhe Airplay 2.
Eco Standby	Mbani shtypur butonin ⏻ për 5 sekonda	- Wi-Fi është i fikur. - Produkti hyn në modalitetin e konsumit të ulët të energjisë. - Rindezja e sistemit do të zgjatë njëfarë kohe.

- ⑥ Ekran
- ⑦ Sensori i telekomandës
- ⑧ Drita LED e energjisë
- ⑨ Treguesi LED i Wi-Fi (E verdhë)

Drita LED	Statusi
Pulson	Modaliteti Wi-Fi Access Point (AP)
Pulson dy herë	Modaliteti Wi-Fi Protected Setup (WPS)
Ndezur konstante	U lidh / U çftua me sukses

Konektorët

Kjo pjesë përmban një përmbledhje të konektorëve të disponueshëm në Soundbar.




- ① **USB**
 - Hyrja audio nga një pajisje memorieje USB.
 - Përditësoni softuerin e këtij produkti.
- ② **AUX**
Hyrje e audios, për shembull, një aparat MP3 (xhek 3,5 mm).
- ③ **OPTICAL**
Lidhni një dalje audio optike me televizorin ose një pajisje dixhitale.
- ④ **Butoni (Konfigurimi i Wi-Fi)**
 - Aktivizoni konfigurimin e Wi-Fi për Play-Fi.
 - Mbani shtypur butonin për 3 sekonda për të aktivizuar modalitetin WPS.
 - Mbani shtypur butonin për 8 sekonda për të aktivizuar modalitetin AP.

- ⑤ **HDMI OUT (eARC/ARC)**
Lidhuni me hyrjen HDMI në televizor.
- ⑥ **HDMI 1/ HDMI 2**
Lidhuni me hyrjen HDMI në televizor.
- ⑦ **AC~ Priza**
Lidhja me energjinë.
- ⑧ **Vendi i kllapës së murit**

Subwoofer me valë

Kjo pjesë përfshin një përmbledhje të Subwoofer me valë.



- ① **AC~ Priza**
Lidhja me energjinë.
- ② **Butoni i çiftimit**
Mbajeni shtypur për të hyrë në modalitetin e çiftimit për Subwoofer.
- ③ **Treguesi i Subwoofer**
Përcaktoni statusin në bazë të treguesit të Subwoofer me valë.

Drita LED	Statusi
Pulsim i shpejtë	Subwoofer në modalitetin e çiftimit
Ndezur konstante	U lidh / U çftua me sukses
Pulsim i ngadalhtë	Lidhja / Çiftimi dështoi

Telekomanda

Në këtë pjesë gjendet një përmbledhje për telekomandën.

① (Standby-On)

Gjendja e energjisë	Veprimi	Funksioni
Ndezur		Gjendja e ndjekjes së burimit
Gjysmë Standby	Shtypni butonin  një herë	- Wi-Fi është ende i ndezur. - Mbështet ende Play-Fi dhe Airplay 2.
Eco Standby	Mbani shtypur butonin  për 5 sekonda	- Wi-Fi është i fikur. - Produkti hyn në modalitetin e konsumit të ulët të energjisë. - Rindezja e sistemit do të zgjatë njëfarë kohe.

② (Burimi)

- Zgjidhni një burim hyrjeje për Soundbar.
- Mbajeni shtypur për të aktivizuar funksionin e çiftimit në modalitetin e Bluetooth ose për ta shkëputur pajisjen Bluetooth të çiftuar aktualisht.

③ (Dolby)

Aktivizoni/çaktivizoni Dolby.

④ (Heshtje)

Heshtni ose riktheni volumin.

⑤ (Luaj/Pauzë)

- Filloni, ndaloni ose vazhdoni luajtjen në modalitetin USB / BT / PLAY-Fi.
- Konfirmoni një zgjedhje.

⑥ (Kursorët)

(E mëparshme/Tjetra)


- Kaloni te kënga e mëparshme ose kënga tjetër në modalitetin USB / BT / PLAY-Fi.
- Navigoni majtas/djathtas në strukturën e menisë.

(Kursorët)

- Navigoni poshtë/lart në strukturën e menisë.

⑦ (MENU)

Hyni në menunë e konfigurimit.



⑧ (Mbrapa)

- Kthehuni në menunë e mëparshme. Dilni nga menuja.
- Mbani shtypur butonin për 10 sekonda për të rivendosur parametrat e fabrikës të modulit Wi-Fi të Soundbar.

⑨ +/- (Volumi i Soundbar)

Rriteni ose uleni volumin e Soundbar.

⑩ +/- (Volumi i Subwoofer)

Rriteni ose uleni volumin e Subwoofer.


Përgatitja e telekomandës

- Telekomanda e dhënë i jep mundësi aparatit që të përdoret nga njëfarë distance.
- Edhe nëse telekomanda përdoret brenda distancës efektive prej 6 m, përdorimi i telekomandës mund të mos jetë i mundur nëse ka pengesa mes aparatit dhe telekomandës.

- Nëse telekomanda përdoret pranë produkteve të tjera që gjenerojnë rreze infrared, ose nëse aparatit përdoren telekomanda të tjera me infrared, ajo mund të mos punojë si duhet. Përndryshe, produktet e tjera mund të mos punojnë si duhet.

Përdorimi për herë të parë:


Aparati ka një bateri litiumi CR2025 të montuar paraprakisht. Hiqeni veshjen mbrojtëse për të aktivizuar baterinë e telekomandës.



Ndërrimi i baterisë së telekomandës

Telekomanda ka nevojë për një bateri litiumi 3V CR2025.

- Përdorni mjete (si bateri monedhë/monedha) për ta kapur zgavrën e kapakut të baterisë dhe rrotullojeni në drejtim të kundërt të akrepave për ta hapur.
- Hiqeni baterinë e vjetër, e cila ndodhet në kapak, vendosni baterinë e re CR2025 dhe kushtojini vëmendje polaritetit të duhur (+/-).
- Përdorni mjetet për ta kapur zgavrën e pjesës së baterive dhe rrotullojeni në drejtim të akrepave të orës për ta fiksuar (kyçur) në telekomandë.




Masa paraprake lidhur me bateritë

- Kur telekomanda nuk do të përdoret për kohë të gjatë (më shumë se një muaj), hiqeni baterinë nga telekomanda që të mos e lejoni të rrjedhë.

- Nëse bateritë rrjedhin, pastrojeni pjesën e derdhur brenda vendit të baterisë dhe ndërrojeni bateritë me të reja.
- Mos përdorni bateri të tjera përveç atyre që janë specifikuar.
- Mos i nxehni ose çmontoni bateritë.
- Asnjëherë mos i hidhni në zjarr ose në ujë.
- Mos i mbani ose mos i ruani bateritë bashkë me objekte të tjera metalike. Kjo mund të bëjë që bateritë të krijojnë qark të shkurtër ose të pëlçasin.
- Asnjëherë mos e karikoni një bateri përveç nëse është konfirmuar se është bateri e karikueshme.

Vendosja

Vendoseni Subwoofer të paktën 1 metër larg Soundbar dhe dhjetë centimetra larg murit. Për rezultate më të mira, vendoseni Subwoofer siç tregohet më poshtë.




Montimi në mur

Shënim

- Montimi jo i mirë në mur mund të shkaktojë aksidente ose dëmtime. Nëse keni ndonjë pyetje, kontaktoni kujdesin për klientin në vendin tuaj.
- Para se ta montoni në mur, sigurohuni që muri është në gjendje të mbajë peshën e Soundbar.
- Para se ta montoni në mur, duhet të hiqni këmbët prej gome poshtë Soundbar, përndryshe këmbët prej gome nuk mund të fiksohen përsëri.
- Në varësi të mënyrës së montimit të Soundbar në mur, sigurohuni që të përdorni vida me gjatësi dhe diametër të përshtatshëm.
- Ju lutemi kontrolloni nëse porta USB mbrapa Soundbar është e lidhur me një pajisje USB. Nëse zbulohet se pajisja USB ndikon te montimi në mur, duhet të përdorni një pajisje tjetër me madhësi të përshtatshme.

Gjatësia/diametri i vidave



Lartësia e rekomanduar për montimin në mur

Rekomandohet që ta montoni televizorin para se ta montoni Soundbar. Kur televizori është i montuar përpara, montojeni Soundbar 50 mm/2,0" larg nga pjesa e poshtme e televizorit.

- 1 Shpini 2 vrima paralele në mur (Ø 3-8 mm secila, në varësi të llojit të murit).

↳ Distancat mes vrimave janë:

- 856 mm / 33,7" (TAB8405 / TAB8505)
- 1017 mm / 40" (TAB8805)
- 1076 mm / 42" (TAB8905)


↳ Mund ta përdorni modelin e montimit në mur për të na ndihmuar të shpojmë pozicionin e vrimave në mur.

↳ Fiksoni upat dhe vidat në vrima.

- 2 Hiqini vidat (x4) nga aparati.

↳ Vendosini kllapat në mur (x2) në aparat me vidat të hequra nga aparati.

- 3 Vareni Soundbar në vida.



3 Lidhja

Kjo pjesë ju ndihmon që ta lidhni Soundbar me televizorin dhe me pajisje të tjera, dhe më pas ta konfiguroni.

Për informacion rreth lidhjeve bazë të Soundbar dhe aksesoreve, shikoni udhëzuesin e shpejtë.

Shënim

- Për të parë shenjat identifikuese dhe vlerat e energjisë, shikoni etiketën e të dhënave mbrapa ose poshtë produktit.
- Para se të bëni ose të ndryshoni ndonjë lidhje, sigurohuni që të gjitha pajisjet të jenë shkëputur nga energjia.

Dolby Atmos®

Dolby Atmos ju jep eksperiencë fantastike dëgjimi duke ju dhënë zë në hapësirë tredimensionale, dhe të gjithë pasurinë, qartësinë dhe fuqinë e tingullit Dolby. Për më shumë informacion, ju lutemi vizitoni dolby.com/technologies/dolby-atmos

Për përdorimin e Dolby Atmos®

Dolby Atmos® është i disponueshëm vetëm në modalitetin HDMI ARC/eARC. Për hollësi të lidhjes, ju lutemi shikoni "**Lidhja HDMI**".

- 1 Për të përdorur Dolby Atmos® në modalitetin HDMI 1 / HDMI 2 / HDMI ARC, televizori duhet të ketë Dolby Atmos®.
- 2 Sigurohuni që të zgjidhet "No Encoding" për bistream në daljen dixhitale të audios të pajisjes së jashtme të lidhur (p.sh. aparat Blu-ray DVD, televizor etj.).
- 3 Kur vendosni formatin Dolby Atmos / Dolby Digital / PCM, Soundbar do të shfaqë DOLBY ATMOS / DOLBY AUDIO / PCM AUDIO / DOLBY SURROUND.

Shënim


- Eksperienca e plotë e Dolby Atmos është e disponueshme vetëm kur Soundbar lidhet me një burim nëpërmjet një kabllu HDMI 2.0.
- Soundbar do të vazhdojë të funksionojë kur lidhet me metoda të tjera (si për shembull me kabëll Digital Optical), por këto nuk janë në gjendje të mbështetnin të gjitha veçoritë e Dolby. Duke pasur parasysh këtë, rekomandimi ynë është që lidhja të bëhet me HDMI, për të siguruar mbështetjen e plotë të Dolby.

Lidhja me prizën HDMI

Disa televizorë 4K HDR kërkojnë që hyrja HDMI ose cilësimet e figurës të konfigurohen për marrjen e materialit HDR. Për hollësi të mëtejshme konfigurimi lidhur me HDR, ju lutemi shikoni manualin e udhëzimeve të televizorit.

Opsioni 1: eARC/ARC (Audio Return Channel)

Soundbar juaj mbështet HDMI me Audio Return Channel (eARC/ARC). Nëse televizori juaj është i pajtueshëm me HDMI ARC, mund ta dëgjoni audion e televizorit nëpërmjet Soundbar duke përdorur një kabull HDMI të vetëm.




- 1 Në televizor, aktivizoni veprimet HDMI-CEC. Për hollësi, shikoni manualin e përdorimit.
 - Konektori **HDMI ARC** ose televizori mund të jenë emërtuar ndryshe. Për hollësi, shikoni manualin e përdorimit.
- 2 Duke përdorur një kablllo High Speed HDMI, lidhni konektorin **HDMI OUT (eARC/ARC)-TO TV** në Soundbar me konektorin **HDMI ARC** në televizor.

Shënim

- Televizori duhet të mbështetë funksionin HDMI-CEC dhe ARC. HDMI-CEC dhe ARC duhet të jenë të aktivizuara.
- Mënyra e konfigurimit të HDMI-CEC dhe ARC mund të ndryshojnë në varësi të televizorit. Për hollësi rreth funksionit ARC, ju lutem shikoni manualin e përdorimit të televizorit.
- Sigurohuni të përdorni kablo HDMI që mbështetin funksionin ARC.


Opsioni 2: HDMI standarde

Nëse televizori juaj nuk mbështet HDMI ARC, lidhni Soundbar me televizorin nëpërmjet një lidhjeje HDMI standarde.



- 1 Përdorni një kablo HDMI për ta lidhur prizën **HDMI IN (1 ose 2)** të Soundbar me pajisjet tuaja të jashtme (p.sh. konsol lojërash, aparate DVD dhe Blu ray).
- 2 Përdorni një kablo HDMI për të lidhur prizën **HDMI OUT (eARC/ARC)** të Soundbar me prizën HDMI IN të televizorit.


Lidhja me një prizë optike



- 1 Duke përdorur një kabell optik, lidhni konektorin **OPTICAL** në Soundbar me konektorin **OPTICAL OUT** në televizor ose në ndonjë pajisje tjetër.
 - Konektori optik dixhital mund të jetë emërtuar **SPDIF** ose **SPDIF OUT**.

Lidhja me prizën AUX

- a. Përdorni një kablo audio 3,5 mm me 3,5 mm
 - Përdorni një kablo audio 3,5 mm me 3,5 mm (nuk është përfshirë) për të lidhur prizën e kufjeve me prizën AUX në aparat.




- b. Përdorni një kablo audio RCA me 3,5 mm
 - Përdorni një kablo audio RCA me 3,5 mm (nuk është përfshirë) për të lidhur prizat e daljes audio të televizorit me prizën AUX në aparat.

Lidhja me energjinë

- Para se të lidhni kordonin e energjisë AC, sigurohuni që të keni bërë të gjitha lidhjet e tjera.
- **Rrezik i dëmtimit të produktit!** Sigurohuni që tensioni i energjisë përputhet me tensionin që është printuar mbrapa ose poshtë aparatit.

- 1 Lidhni kabllon e energjisë me prizën AC~ të aparatit dhe pastaj futeni në prizën në mur
- 2 Lidhni kabllon e energjisë me prizën AC~ në të Subwoofer dhe pastaj futeni në prizën në mur.




* Kordoni i energjisë dhe lloji i spinës ndryshon sipas vendeve.

Çiftimi me Subwoofer

Çiftimi automatik

Lidhni Soundbar me Subwoofer në prizat e energjisë dhe më pas shtypni mbi aparat ose telekomandë për **tandezur** pajisjen. Subwoofer dhe Soundbar do të lidhen automatikisht.



➔ Përcaktoni statusin në bazë të treguesit të Subwoofer me valë.

Drita LED	Statusi
Pulsim i shpejtë	Subwoofer në modalitetin e çiftimit
Ndezur konstante	U lidh / U çiftua me sukses
Pulsim i ngadalhtë	Lidhja / Çiftimi dështoi

Këshilla

- Mos shtypni butonin Pair mbrapa Subwoofer, përveçse për të bërë çiftimin manual.

Çiftimi manual

Nëse është e pamundur të dëgjohet audio nga Subwoofer me valë, çiftojeni manualisht subwoofer.

- 1 Shkëputini përsëri të dyja pajisjet nga priza e energjisë, dhe më pas lidhni përsëri pas 3 minutash.
- 2 Mbani shtypur butonin **Pair** në pjesën e pasme të Subwoofer për 5 sekonda.
 - ➔ Treguesi Pair në Subwoofer do të pulsojë shpejt.
- 3 Mbani shtypur **⏻** për 5 sekonda në aparat ose në telekomandë për ta kaluar aparatit në modalitetin ECO STANDBY. Më pas shtypni **⏻** në aparat ose në telekomandë për ta ndezur aparatit.
 - ➔ Treguesi **Pair** në Subwoofer do të mbetet solid kur çiftimi të bëhet me sukses.
- 5 Nëse treguesi Pair vazhdon të pulsojë, përsëritni hapat 1-3.

Këshilla

- Subwoofer duhet të jetë jo më shumë se 6 m larg Soundbar në një vend të hapur (sa më afër aq më mirë).
- Hiqni çdo objekt mes Subwoofer dhe Soundbar.
- Nëse lidhja me valë dështon përsëri, kontrolloni nëse ka konflikt ose interferencë të fortë (p.sh. interferencë nga një pajisje elektronike) anëmbanë vendit. Hiqini këto konflikte ose interferenca të forta dhe përsëritni procedurat e mësipërme.

Lidhja me Wi-Fi (punim me Wireless)

(për versionin iOS dhe Android)

Duke i lidhur këtë aparat dhe telefonat celularë, tabletë (si iPad, iPhone, iPod touch, telefona Android, etj.) me të njëjtin rrjet Wi-Fi, mund ta përdorni më pas aplikacionin Philips Sound të mundësuar nga DTS Play-Fi për të kontrolluar Soundbar për të dëgjuar skedarë audio.

- 1 Lidhni telefonin ose tabletën me të njëjtin rrjet Wi-Fi me të cilin doni të lidhni Soundbar.
- 2 Shkarkoni dhe instaloni në një telefon ose tabletë aplikacionin Philips Sound të mundësuar nga DTS Play-Fi.



- Sigurohuni që routeri është i ndezur dhe që funksionon si duhet.

- 3 Mbani shtypur butonin (Wi-Fi) që ndodhet në kabinetin e pasmë për 8 sek për të aktivizuar lidhjen Wi-Fi.
↳ Derisa boksi të lëshojë një ton të dytë, dhe më pas lëshojeni butonin.

- 4 Prisni derisa treguesi i dritës Wi-Fi përpara kabinetin të kalojë nga pulsime të shpejta në pulsime të ngadalta. Kur të fillojë të pulsojë ngadalë, kjo tregon se boks po hyn në modalitetin e konfigurimit WPS.

- 5 Hapni aplikacionin Philips Sound të mundësuar nga DTS Play-Fi. Ndiqni udhëzimet në aplikacion për ta lidhur këtë produkt me rrjetin Wi-Fi.

Shënim

Vetëm për versionin iOS

Rrjeti Wi-Fi i përdorur përkohësisht nga iPhone duhet të kalohet përkohësisht te pajisja Play-Fi AP dhe rihapeni aplikacionin Philips Sound për të përfunduar konfigurimin Wi-Fi të produktit. Shikoni hapat e mëposhtëm:

- Shkoni te Cilësimet.
- Zgjidhni konfigurimin Wi-Fi.



- Zgjidhni pajisjen Play-Fi në konfigurimin e Wi-Fi.
- Ktheshuni te aplikacioni Philips Sound për të vazhduar konfigurimin.



- 6 Pas lidhjes me sukses të Wi-Fi, drita treguese e Wi-Fi përpara do të ndalojë së pulsuar dhe do të qëndrojë ndezur. Pasi ta konfiguroni këtë produkt në rrjetin tuaj Wi-Fi, mund ta kontrolloni nga cilido smartfon ose tabletë në të njëjtin rrjet.
↳ Kur e përdorni aplikacionin për të luajtur muzikë, paneli i ekranit do të shfaqë PLAY-Fi.
- 7 Pas lidhjes, mund ta ndryshoni emrin e pajisjes. Ka disa emra mes të cilëve mund të zgjidhni ose mund të krijoni tuajin duke zgjedhur Emër i personalizuar në fund të listës së emrave. Përndryshe, ndjek emrin standard.

- 8** Pas lidhjes, ky produkt mund të bëjë një përditësim të sistemit. Përditësojeni softuerin në versionin më të fundit kur të bëni konfigurimin për herë të parë. Përditësimi i softuerit mund të zgjatë disa minuta. Mos e shkëputni boksën, mos e fikni pajisjen ose mos e u largoni nga rrjeti gjatë përditësimit.

Konfigurimi i AirPlay

Përdorni AirPlay për të konfiguruar lidhjen Wi-Fi të pajisjes iOS (iOS7 ose më i ri) dhe të Soundbar.

- 1** Pajisja iOS: Cilësimet > Wi-Fi > zgjidhni rrjetin e shtëpisë [**Pajisja Play-Fi (xxxxxx)**]
- 2** Hapni aplikacionin Philips Sound të mundësuar nga DTS Play-Fi. Ndiqni udhëzimet në aplikacion për ta lidhur këtë produkt me rrjetin Wi-Fi.
 - ↳ Pas lidhjes me sukses të Wi-Fi, drita treguese e Wi-Fi përpara do të ndalojë së pulsuar dhe do të qëndrojë ndezur. Pasi ta konfiguroni këtë produkt në rrjetin tuaj Wi-Fi, mund ta kontrolloni nga cilido smartfon ose tabletë në të njëjtin rrjet.
 - ↳ Kur e përdorni aplikacionin për të luajtur muzikë, paneli i ekranit do të shfaqë PLAY-FI.
- 3** Pas lidhjes, mund ta ndryshoni emrin e pajisjes. Ka disa emra mes të cilëve mund të zgjidhni ose mund të krijoni tuajin duke zgjedhur Emër i personalizuar në fund të listës së emrave. Përndryshe, ndjek emrin standard.
- 4** Pas lidhjes, ky produkt mund të bëjë një përditësim të sistemit. Përditësojeni softuerin në versionin më të fundit kur të bëni konfigurimin për herë të parë. Përditësimi i softuerit mund të zgjatë disa minuta. Mos e shkëputni boksën, mos e fikni pajisjen ose mos e u largoni nga rrjeti gjatë përditësimit.

Shënim

- Pas lidhjes, produkti mund të bëjë një përditësim të softuerit. Kërket përditësim pas konfigurimit fillestar. Pa bërë përditësimin, jo të gjitha veçoritë e produktit mund të jenë të disponueshme.
- Kur konfigurimi për herë të parë nuk është i suksesshëm, mbani shtypur butonin Wi-Fi në Soundbar për 8 sekonda derisa të dëgjohet toni dhe drita e Wi-Fi të ndryshohet në puls të ngadaltë. Rivendosni lidhjen Wi-Fi, rihapeni aplikacionin dhe filloni konfigurimin përsëri.
- Nëse doni të kaloni nga një rrjet te një tjetër, duhet të konfiguroni lidhjen përsëri. Mbani shtypur butonin  (Wi-Fi) në Soundbar për 8 sekonda për të rivendosur lidhjen Wi-Fi.

Modaliteti WPS

Nëse routeri juaj ka Wi-Fi Protected Setup (WPS), mund ta konfiguroni lidhjen pa formuar fjalëkalim.

- 1** Mbani shtypur butonin Wi-Fi për 4 sekonda. Do të dëgjoni një ton dhe drita Wi-Fi do të fillojë të pulsojë dy herë.
- 2** Shtypni butonin WPS në router. Zakonisht, butoni është shënuar me këtë logo WPS. 
- 3** Ndiqni udhëzimet në aplikacionin Philips Sound të mundësuar nga DTS Play-Fi për të filluar çiftimin.



Shënim

- WPS nuk është një veçori standarde në të gjithë routerët. Nëse routeri juaj nuk ka WPS, atëherë përdorni Standard Wi-Fi Setup.
- Shtypni butonin  (Wi-Fi) një herë nëse doni të dilni nga modaliteti WPS, përndryshe ai do të mbyllet automatikisht pas 2 minutash.

4 Përdorimi i Soundbar

Kjo pjesë ju ndihmon ta përdorni Soundbar për të luajtur audio nga pajisjet e lidhura.

Para se të filloni

- Bëni lidhjet e nevojshme të treguara në udhëzuesin e shpejtë dhe në manualin e përdorimit.
- Kalojeni Soundbar te burimi i duhur për pajisjet e tjera.

Ndezja dhe fikja

- Kur e lidhni pajisjen me prizën e energjisë për herë të parë, pajisja do të jetë në gjendjen STANDBY. Treguesi STANDBY do të ndizet në ngjyrë të bardhë.

Gjendja e energjisë	Veprimi	Funksioni
Ndezur		• Gjendja e ndjekjes së burimit
Gjysmë Standby	Shtypni butonin  një herë	• Wi-Fi është ende i ndezur. • Mbështet ende Play-Fi dhe Airplay 2.
Eco Standby	Mbani shtypur butonin  për 5 sekonda	• Wi-Fi është i fikur. • Produkti hyn në modalitetin e konsumit të ulët të energjisë. • Rindezja e sistemit do të zgjatë njëfarë kohe.

Gjendje pritjeje automatike

Pajisja kalon automatikisht në modalitetin në pritje ose Standby pas rreth 15 minutash nëse televizori ose pajisja e jashtme shkëputet (funksioni USB, BT, Play-Fi) ose fiket.

- Për ta fikur pajisjen komplet, hiqeni spinën nga priza.
- Ju lutemi fiken pajisjen komplet për të kursyer energji kur nuk e përdorni.

Zgjedhja e modaliteteve

- 1 Shtypni vazhdimisht butonin  në aparat ose në telekomandë për të zgjedhur modalitetin **AUX, OPTICAL, HDMI eARC/ARC, HDMI 1, HDMI 2, BT, USB**.
 - ↳ Modaliteti i zgjedhur do të shfaqet në ekran.
 - ↳ Play-Fi nuk është një burim opsional. Play-Fi duhet të kontrollohet direkt nga aplikacioni.

Ndryshimi i volumit

Ndryshoni volumin e Soundbar

- 1 Shtypni  +/- (**Volumi**) për të rritur ose ulur nivelin e volumit.
 - Për ta heshtur zërin, shtypni **Heshtje**.
 - Për të rikthyer zërin, shtypni **Heshtje** përsëri ose shtypni **Vol+/Vol-** (**Volumi**).

Ndryshimi i volumit të Subwoofer

- 1 Shtypni  +/- (**Subwoofer**) për ta rritur ose ulur nivelin e volumit të Subwoofer.

Modaliteti i tingullit Dolby

Provoni një eksperiencë fantastike zëri me modalitetet e tingullit Dolby.

- 1 Shtypni butonin  në telekomandë për ta aktivizuar ose çaktivizuar modalitetin Dolby.
 - **On:** Krijoni një eksperiencë dëgjimi Dolby.
 - **Off:** Tingull stereo me dy kanale. Ideal për të dëgjuar muzikë.

Rivendosje e parametrave të fabrikës

Rivendosni pajisjen në konfigurimin standard

- Në modalitetin në pritje, shtypni me radhë butonat ►, ◀, vol-] në telekomandë, në ekran shfaqet "RESET" për të rivendosur parametrat e fabrikës të hostit.
- Konfigurimi është aktiv, mbani shtypur butonin ◀ derisa në ekran të shfaqet "RESET" për ta rivendosur modulën Wi-Fi në parametrat standarde të fabrikës.

Menuja e konfigurimit

Aparati ju jep mundësi të konfiguroni parametrat standarde që t'ju ofrojnë një eksperiencë edhe më të mirë.

- Shtypni butonin  (MENU) në telekomandë për të hapur menunë.
- Zgjidhni përmbajtjen me butonat ▼/▲ (Lart / Poshtë) në telekomandë.

Ekrani 	Përshkrim
EQ	Zgjidhni efektin e ekualizuesit (EQ)
BASS	Rregullo nivelin e basit
TREBLE	Rregullo nivelin e Treble
AV SYNC	Vendos vonesën e audios
CENT	Rregullo volumnin e kanalit të mesit (vetëm TAB8805, TAB8905)
TOP	Rregullo volumnin e kanalit të sipërm (vetëm TAB8905)
DIM	Vendos ndriçimin e ekranit
DISPLAY	Fik automatikisht ekranin
KEY TONE	Aktivizo/çaktivizo tonin e tasteve

- Shtypni ►|| (Enter) për të konfirmuar zgjedhjen tuaj.
- Ndryshoni vlerat fillestare për secilin prej konfigurimeve me kursorë ◀/► (Majtas / Djathtas).

- Shtypni ►|| (Enter) për të konfirmuar zgjedhjen tuaj.
 - Për t'u kthyer në ekranin e mëparshëm, dilni nga konfigurimet, shtypni ◀ (Mbrapa).
 - Nëse nuk shtypet asnjë buton brenda 5 sekondash, sistemi do të dalë automatikisht nga menuja.

EQ

Zgjidhni modalitetet paraprake të zërit sipas videos dhe muzikës suaj: **MOVIE, MUSIC, VOICE, STADIUM, CUSTOM.**

- MOVIE:** Krijoni një eksperiencë dëgjimi rrethuese. Ideale për të parë filma.
- MUSIC:** Krijoni tingull stereo me dy kanale ose shumë kanale. Ideal për të dëgjuar muzikë.
- VOICE:** krijoni efekt zëri që e bën zërin e njeriut më të qartë dhe më të mirë për të dëgjuar.
- STADIUM:** Krijoni një atmosferë sikur shikoni ndeshje sportive në stadium.
- CUSTOM:** Personalizoni zërin sipas preferencave tuaja. Duhet të konfigurohet nëpërmjet aplikacionit Fine Tune.
 - ➔ Si standard, EQ është vendosur në MOVIE.

BASS/TREBLE

Rregulloni nivelin e basit/Treble.

- ➔ BAS -5 ~ BAS +5
- ➔ TRB -5 ~ TRB +5
- ➔ Si standard, basi/Treble është vendosur në 0.

AV SYNC

Vendosni vonesën e audios.

- Përpunimi i imazhit të videos, ndonjëherë më i gjatë se koha që duhet për të përpunuar sinjalin e audios. Kjo quhet "vonesë." Veçoria e vonesës së audios është bërë për të zgjidhur këtë vonesë.
- Vendosni vonesën e audios, e cila ofrohet vetëm për këtë modalitet luajtjeje. (Siç sigurohet në modalitetin e vonesës së audios HDMI ARC, modaliteti

i vonesës është i vlefshëm vetëm për HDMI ARC).

↳ AV00 ~ AV200

↳ Si standard, vonesa e audios është vendosur në 00.

CENT (CENTER)

(vetëm TAB8805, TAB8905)

Rregullo volumin e kanalit të mesit

↳ CTR -5 ~ CTR +5

↳ Si standard, volumi i kanalit të audios është vendosur në 0.

TOP (vetëm TAB8905)

Rregullo volumin e kanalit të sipërm

↳ TOP +5 ~ TOP -5

↳ Si standard, tingulli i kanalit të sipërm është vendosur në 0.

DIM

Vendosni ndriçimin e ekranit.

↳ DIM 03, DIM 02, DIM 01

↳ Si standard, errësuesi është vendosur në DIM 03.

DISPLAY

Vendosni që ekranin të fiket automatikisht (përveç treguesit LED të Wi-Fi) pas 3 sekondash nëse nuk ndodh asnjë veprim nga përdoruesi.

↳ ON: Vendosni që ekranin të jetë ndezur

↳ OFF: Vendosni që ekranin të jetë fikur

↳ Si standard, ekranin është vendosur në ON.

KEY TONE

Aktivizo/çaktivizo tonin e tasteve

↳ ON: Vendoseni në ON

↳ OFF: Vendoseni në OFF

↳ Si standard, toni i tasteve është vendosur në off.

Punimi me Bluetooth

Duke përdorur Bluetooth, lidhjeni Soundbar me pajisjen Bluetooth (si iPad, iPhone, iPod touch, telefon Android, ose laptop), dhe më pas mund të dëgjoni skedarët audio të ruajtur në pajisje me anë të bokseve Soundbar.

- 1 Shtypni vazhdimisht butonin  në aparat ose në telekomandë për ta kaluar Soundbar në modalitetin e Bluetooth.
↳ **NO BT** shfaqet në ekran.
- 2 Në pajisjen e Bluetooth, ndizeni Bluetooth, kërkonti dhe zgjidhni **Philips TAB8405** për të filluar lidhjen (shikoni manualin e përdorimit të pajisjes Bluetooth se si të aktivizoni Bluetooth).
- 3 Prisni derisa të dëgjoni komentin me zë nga Soundbar.
↳ Nëse lidhja bëhet me sukses, **BT** shfaqet në ekran.
- 4 Zgjidhni dhe luani skedarë audio ose muzikë në pajisjen Bluetooth.
 - Gjatë luajtjes, nëse vjen një telefonatë, muzika ndalohej. Luajtja vazhdon kur telefonata përfundon.
 - Nëse pajisja Bluetooth mbështet profilin AVRCP, në telekomandë mund të shtypni  /  për ta kapërcyer një këngë, ose shtypni  për ta ndaluar/vazhduar luajtjen.
- 5 Për të dalë nga Bluetooth, zgjidhni një burim tjetër.
 - Kur e riktheheni në modalitetin Bluetooth, lidhja Bluetooth qëndron aktive.
 - Nëse doni ta lidhni Soundbar me një pajisje tjetër Bluetooth, shtypni dhe mbani shtypur  në telekomandë për ta shkëputur pajisjen Bluetooth të lidhur aktualisht.



Shënim

- Një pajisje Bluetooth që mbështet profilin Bluetooth A2DP, AVRCP dhe me Bluetooth versioni 4.2 + EDR.
- Distanca funksionale maksimale mes Soundbar dhe një pajisjeje Bluetooth është rreth 10 metra.
- Nuk garantohet pajtueshmëria me të gjitha pajisjet me Bluetooth.
- Transmetimi streaming i muzikës mund të ndërpritet nga pengesat mes pajisjes dhe Soundbar si muri, kasa metalike që mbulon pajisjen, ose pajisje të tjera pranë që punojnë në të njëjtën frekuencë.

Punimi me AUX / OPTICAL / HDMI ARC

Sigurohuni që pajisja është e lidhur me televizorin ose pajisjen audio.

- 1 Shtypni vazhdimisht butonin  në aparat ose në telekomandë për të zgjedhur modalitetin **AUX, OPTICAL, HDMI eARC/ARC, HDMI 1, HDMI 2**.
- 2 Përdorimi i pajisjes audio direkt për veçoritë e luajtjes.
- 3 Shtypni butonat **VOL +/-** për ta çuar volumnin në nivelin që doni.


Këshillë

- Gjatë kohës që jeni në modalitetin OPTICAL / HDMI ARC, nëse nuk ka dalje zëri nga pajisja dhe treguesi i statusit pulson, mund t'ju duhet të aktivizoni daljen e sinjalit PCM ose Dolby Digital në pajisjen burim (p.sh. TV, DVD ose aparat Blu-ray).
- Pajisja mund të mos jetë në gjendje t'i dekodojë të gjitha formatet dixhitale audio nga burimi i hyrjes. Në këtë rast, pajisja do të heshtet. Ky nuk është defekt. Sigurohuni që konfigurimi i audios së burimit të hyrjes (p.sh., televizori, konsoli i lojërave, aparati DVD, etj.) të jetë vendosur në PCM ose Dolby Digital (Shikoni manualin e përdorimit të pajisjes së burimit të hyrjes për hollësi lidhur me konfigurimin e audios) me HDMI 1 / HDMI 2 / HDMI ARC / hyrje optike.
- Në modalitetin HDMI, kur vendoset formati i audios DOLBY ATMOS, në ekranin e Soundbar shfaqet DOLBY ATMOS.
- Kur vendoset formati i audios DOLBY DIGITAL, nëse aktivizohet tingulli rrethues, në ekran do të shfaqet DOLBY SURROUND, nëse tingulli rrethues fiket, në ekran do të shfaqet DOLBY AUDIO.
- Kur vendoset formati i audios PCM, në ekranin e Soundbar shfaqet PCM AUDIO.
- Kur vendosni formatet e audios jo-PCM ose DOLBY DIGITAL, nëse nuk ka dalje zëri nga aparati, në ekran shfaqet ERROR.

Punimi me USB

Dëgjoni audio në një pajisje memorieje USB, si aparat MP3, memorie USB etj.

- 1 Vendosni pajisjen e memories USB.



- 2 Shtypni vazhdimisht butonin  në aparat ose në telekomandë për të zgjedhur modalitetin **USB**.
- 3 Gjatë luajtjes:

Butoni	Veprimi
	Filloni, ndaloni ose vazhdoni luajtjen.
	Kaloni te kënga e mëparshme ose kënga tjetër.

Këshilla

- Ky produkt mund të mos jetë i pajtueshëm me disa lloje të caktuara të pajisjeve të memories me USB.
- Nëse përdorni kabllo USB zgjatues, USB hub, ose lexues multifunksional kartash, pajisja e memories USB mund të mos njihet.
- Mos e hiqni këtë pajisje memorieje USB ndërsa lexoni skedarët.
- Pajisja mund të mbështetë pajisje USB me memorie deri në 32 GB.
- Kjo pajisje mund të luajë MP3 / WAV / FLAC.
- Mbështet një portë USB: 5 V --- 500 mA.

Dëgjimi i Spotify

Përdoreni telefonin, tabletën ose kompjuterin si telekomandë për Spotify. Shkoni në spotify.com/connect për të mësuar se si.

Përditësimi i firmuerit

Për të marrë veçoritë dhe suportin më të mirë, përditësojeni produktin me versionin më të fundit të firmuerit.

Opsioni 1:

Përditësojeni firmuerin nëpërmjet aplikacionit Philips Sound (Cilësimet > PS Fine Tune)

Firmueri për MCU dhe DSP mund të përditësohet në versionin më të fundit nëpërmjet aplikacionit Philips Sound të mundësuar nga DTS Play-Fi. Ju lutemi shkoni te menuja e cilësimeve dhe zgjidhni opsionin PS Fine Tune për ta provuar. Nëse përditësimi ka dalë, ikona e përditësimit mund të shtypet për të kryer përditësimin automatikisht. Pasi ky produkt të lidhet me Wi-Fi, ai mund të marrë përditësimin e firmuerit over-the-air. Përditësojeni gjithnjë në versionin më të fundit të firmuerit për të përmirësuar performancën e këtij produkti.

Opsioni 2:

Përditësojeni firmuerin nëpërmjet USB

- 1 Shikoni nëse në www.philips.com/support gjendet versioni më i fundit i firmuerit. Kërkoni modelin tuaj dhe klikoni "Softuerët dhe drajverat".
- 2 Shkarkojeni firmuerin në një pajisje memorieje USB.
- 3 Ndiqni udhëzimet për përditësimin e firmuerit.

5 Të dhënat e produktit

Shënim

- Të dhënat dhe dizajni mund të ndryshohen pa u njoftuar.

Bluetooth / Wireless

- Profilet Bluetooth: A2DP, AVRCP
- Versioni i Bluetooth: 4.2 + EDR
- Banda e frekuencave/Fuqia Output: 2400 MHz ~ 2483,5 MHz / ≤ 5 dBm
- Rrezja e frekuencave 2,4 G Wireless/Fuqia Output: 2400 MHz ~ 2483 MHz / ≤ 6 dBm

Rrjeti që mbështetet

- WiFi IEEE 802.11a/b/g/n/ac Banda e frekuencave Wireless (Wi-Fi) / Fuqia e transmetuar e frekuencave radio 2,4 G Wi-Fi: 2400 MHz ~ 2483,5 MHz / ≤ 20 dBm
5,1 G Wi-Fi: 5150 MHz ~ 5350 MHz / ≤ 20 dBm
5,8 G Wi-Fi: 5725 MHz ~ 5850 MHz / ≤ 14 dBm

Aparati

- Furnizimi me energji: 100–240 V~ 50/60 Hz
- Fuqia output: 120 W
- Konsumi i energjisë: 25 W
- Konsumi në gjendje pritjeje: $< 0,5$ W
- USB: 5 V $\Rightarrow$ 500 mA
- Përgjigja e frekuencës: 150 Hz – 20 KHz
- Ndjeshmëria input audio: 500 mV
- Impedanca e bokseve: 8 Ω x 2
- Përmasat (Gje x La x The): 900 x 57 x 110 mm
- Pesha: 2,4 kg
- Temperatura e operimit: 0°C – 45°C

Subwoofer

- Furnizimi me energji: 100–240 V~, 50–60 Hz
- Fuqia output: 80 W
- Konsumi i energjisë: 20 W
- Konsumi i energjisë në gjendje joaktive: $< 0,5$ W
- Përgjigja e frekuencës: 35 Hz – 150 Hz
- Impedanca: 4 Ω
- Përmasat (Gje x La x The): 120 x 403 x 300 mm
- Pesha: 4,8 kg
- Temperatura e operimit: 0°C – 45°C

Telekomanda

- Distanca/Këndi: 6 m/30°
- Tipi i baterisë: CR2025

Formatet audio që mbështeten

- **HDMI eARC/ARC**
Dolby Digital, Dolby Digital plus, Dolby True HD, Dolby Atmos[®], LPCM 2ch/Mch, Dolby MAT.
- **HDMI IN1/ HDMI IN2**
Dolby Digital, Dolby Digital plus, Dolby True HD, Dolby Atmos[®], LPCM 2ch/Mch, Dolby MAT.
- **OPTICAL**
Dolby Digital, Dolby Digital plus, LPCM 2ch
- **BLUETOOTH**
SBC
- **USB**
MP3 / WAV / FLAC
- **Video**
Përmirësimi i videos: 4K Video Pass-through, Dolby Vision, HDR10, HDR10+

6 Zgjidhja e problemeve



Paralajmërim

- Rrezik goditjeje elektrike. Asnjëherë mos e hiqni kasën e produktit.

Për ta mbajtur garancinë të vlefshme, asnjëherë mos u mundoni ta riparoni produktin vetë.

Nëse keni probleme me përdorimin e produktit, shikoni pikat e mëposhtme para se të kërkonti shërbime. Nëse ende keni problem, kërkonti ndihmë në www.philips.com/support.

Aparati

Butonat në aparatin kryesor nuk punojnë.

- Shkëputeni furnizimin me energji për disa minuta, pastaj lidheni përsëri.

Nuk ka energji

- Sigurohuni që kordoni AC është lidhur si duhet.
- Sigurohuni që në prizën AC ka energji.
- Shtypni butonin e gjendjes në pritje (Standby) në telekomandë ose Soundbar për ta ndezur Soundbar.

Zëri

Nga boksi i Soundbar nuk ka zë.

- Lidheni kabllon e audios nga Soundbar në televizor ose në pajisje të tjera. Megjithatë, nuk ju duhet një lidhje e veçantë audio kur:
 - Soundbar dhe televizori janë lidhur me anë të lidhjes HDMI ARC, ose
 - në konektorin HDMI IN në Soundbar është lidhur një pajisje.
- Zgjidhni hyrjen e duhur të audios në telekomandë.
- Sigurohuni që Soundbar nuk është heshtur.
- Rivendoseni këtë produkt në parametrat e fabrikës (shiko "Apliko parametrat e fabrikës").

Nuk ka zë nga Subwoofer me valë.

- Lidheni manualisht Subwoofer me aparatin kryesor.
- Ngrijeni volumnin. Shtypni butonin e rritjes së volumnit në telekomandë ose në Soundbar.
- Kur përdorni një prej hyrjeve digjitale, nëse nuk ka audio:
 - Provoni ta vendosni daljen e televizorit në PCM ose
 - Lidhuni direkt me burimin Blu-ray/burimin tjetër, disa televizorë nuk kalojnë audio digjitalë.
- Televizori mund të jetë vendosur në dalje audio të ndryshueshme. Kontrolloni nëse dalja audio është vendosur në FIXED ose STANDARD, jo në VARIABLE. Shikoni manualin e përdorimit të televizorit për më shumë informacion.
- Nëse përdorni Bluetooth, sigurohuni që volumni në pajisjen burim të jetë i ngritur dhe që pajisja nuk është heshtur.
- Kur luajtja ngrin dhe nuk ka zë në modalitetin e Wi-Fi, ju lutemi kontrolloni nëse rrjeti i shtëpisë suaj është normal.

Tingulli është i shtrembëruar ose ka eko.

- Nëse luani audio nga televizori nëpërmjet produktit, sigurohuni që televizori është heshtur.

Audio dhe televizori nuk janë të sinkronizuar.

- Shtypni për të sinkronizuar audion me videon.

Bluetooth

Pajisja nuk mund të lidhet me Soundbar.

- Pajisja nuk mbështet profilet e pajtueshme që nevojiten për Soundbar.
- Nuk keni aktivizuar funksionin Bluetooth në pajisje. Shikoni manualin e përdorimit të pajisjes për të parë se si ta aktivizoni funksionin.
- Pajisja nuk është lidhur si duhet. Lidheni pajisjen si duhet.
- Soundbar është lidhur tashmë me një pajisje tjetër Bluetooth. Shkëputeni pajisjen e lidhur, pastaj provoni përsëri.

Cilësia e luajtjes së audios nga një pajisje Bluetooth është e dobët.

- Sinjali i Bluetooth është i dobët. Afrojeni pajisjen me Soundbar, ose hiqni çdo pengesë mes pajisjes dhe Soundbar.

Nuk gjej dot emrin e Bluetooth të këtij aparati në pajisjen time Bluetooth

- Sigurohuni që funksioni Bluetooth është i aktivizuar në pajisjen tuaj Bluetooth.
- Lidheni përsëri aparatin me pajisjen Bluetooth.

Wi-Fi

Nuk është bërë lidhja Wi-Fi.

- Shikoni disponueshmërinë e rrjetit WLAN në router.
- Vendoseni routerin më pranë routerit Wi-Fi në aparat.
- Sigurohuni që fjalëkalimi është i saktë.
- Kontrolloni funksionin WLAN ose rindizeni modemin dhe routerin Wi-Fi.

Dolby Atmos

Nuk është e mundur të arrihen efektet e Dolby Atmos.

- Për lidhjet jo-HDMI (si përdorimi i USB, Bluetooth, OPTICAL ose AUDIO IN), lartësia e efekteve rrethuese është e kufizuar. Shikoni pjesën e "Dolby Atmos" për të parë se si të arrini efektet më të mira të Dolby Atmos.

Play-Fi

Nuk është e mundur të gjenden pajisjet që mbështetin Play-Fi në aplikacion.

- Sigurohuni që pajisja është lidhur me Wi-Fi.

Nuk është e mundur të luhet muzikë Play-Fi.

- Disa shërbime ose përmbajtje rrjeti që disponohen përmes pajisjes, mund të mos jenë të përdorshme në rast se ofruesi i shërbimit e mbyll shërbimin e tij.
- Nëse konfigurimi për herë të parë nuk bëhet me sukses, mbylleni aplikacionin Philips Sound të mundësuar nga DTS Play-Fi. Hapeni përsëri aplikacionin.
- Kur boksi vendoset në Stereo Pairs ose Surround Sound, boksi duhet të shkëputet nga aplikacioni para se të përdoret veçmas.

Telekomanda nuk punon

- Para se të shtypni ndonjë buton për kontrollimin e luajtjes, në fillim zgjidhni burimin e duhur.
- Afrojeni më shumë telekomandën me pajisjen.
- Vendoseni baterinë duke i pozicionuar polaritetet (+/-) siç është treguar.
- Ndërroni baterinë.
- Drejtojeni telekomandën direkt në sensorin përpara pajisjes.

Ky është një funksion fikjeje pas 15 minutash, një nga kërkesat e standardit ERPII për të kursyer energji

- Kur niveli i sinjalit hyrës të jashtëm të pajisjes është tepër i ulët, aparati do të fiket automatikisht pas 15 minutash. Ju lutem rritni volumnin e pajisjes së jashtme.

Subwoofer është në gjendje pritjeje ose Subwoofer nuk ndizet

- Ju lutemi shkëputeni kordonin e energjisë nga priza e energjisë, dhe lidheni përsëri pas 3 minutash për të rivendosur parametrat e Subwoofer.

Markat tregtare:



Për patentat DTS, shikoni <http://patents.dts.com>. Prodhuar me licencë nga DTS, Inc. (për kompanitë me seli në SHBA/Japoni/Tajvan) ose me licencë nga DTS Licensing Limited (për të gjitha kompanitë e tjera). DTS, Play-Fi dhe logoja DTS Play-Fi janë marka të regjistruara tregtare ose marka tregtare të DTS, Inc. në Shtetet e Bashkuara dhe në shtete të tjera. ©2020 DTS, Inc. TË GJITHA TË DREJTAT E REZERVUARA.



Logoja Wi-Fi CERTIFIED™ është një markë e regjistruar tregtare e Wi-Fi Alliance®.



Google, Google Play dhe Chromecast janë marka tregtare të Google LLC. Google Assistant nuk është i disponueshëm në disa gjuhë dhe shtete të caktuara.



Për të kontrolluar këtë boks me AirPlay 2, nevojitet iOS 11.4 ose më i ri. Përdorimi i punimeve me distinktivin Apple do të thotë se një aksesori është përcaktuar të funksionojë me teknologjinë e identifikuar në distinktiv dhe është certifikuar nga markat tregtare të Apple Inc., e regjistruar në SHBA dhe në shtete të tjera.

Apple® dhe AirPlay® janë marka tregtare të Apple Inc., e regjistruar në SHBA dhe në shtete të tjera.



Softueri Spotify është subjekt i licencave të palëve të treta që gjenden këtu: www.spotify.com/connect/third-party-licenses



Termat HDMI, HDMI High-Definition Multimedia Interface dhe logoja HDMI janë marka tregtare ose marka të regjistruara tregtare të HDMI Licensing Administrator, Inc.

COMPATIBLE WITH



Dolby, Dolby Vision, Dolby Atmos dhe simboli me dy D janë marka të regjistruara tregtare të Dolby Laboratories Licensing Corporation. Prodhuar me licencë nga Dolby Laboratories. Punime konfidenciale të papublikuara. Copyright © 2012–2020 Dolby Laboratories. Të gjitha të drejtat e rezervuara.



Fjala dhe logot Bluetooth® janë marka të regjistruara tregtare që zotërohen nga Bluetooth SIG, Inc. dhe çdo përdorim i këtyre markave nga MMD Hong Kong Holding Limited bëhet me licencë. Markat dhe emrat tregtarë të tjerë janë të pronarëve të tyre përkatës.



Specifikimet janë objekt ndryshimi pa njoftim.

Ju lutemi vizitoni <https://www.philips.com/support> për përditësimet dhe dokumentet më të fundit.

Philips dhe Philips Shield Emblem janë marka tregtare të regjistruara të Koninklijke Philips N.V. dhe përdoren me licencë. Ky produkt është prodhuar nga, dhe shitet nën përgjegjësinë e MMD Hong Kong Holding Limited, ose të një prej filialeve të tij, dhe MMD Hong Kong Holding Limited është garantuesi i vetëm në lidhje me këtë produkt.

